



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Nr. 1320 Prot.

Tiranë, më 20.12. 2019

VENDIM

“I Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit”

Nr. 28, datë 20.12.2019

Në zbatim të nenit 8 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit të Gjykatës Kushtetuese” dhe të nenit 10 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”, Mbledhja e Gjyqtarëve,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për organizimin e funksionimin e personelit dhe administrimin e dokumentacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit”, sipas tekstit bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Natasha Mulaj



Për një ndryshim dhe shtesë në rregulloren e Kolegjit të Posaçëm të Apelit “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”

Në mbështetje të nenit 8 të rregullores “ Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese” dhe të nenit 10 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”, e ndryshuar, Mbledhja e Gjyqtarëve,

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 3, pika 3, fjalia “Gjyqtarët informohen në fillim të çdo shorti për ngarkesën e çështjeve në shqyrtim, nga ku rezulton roli i secilit gjyqtar si anëtar i trupit gjykues, si kryesues ose si relator”, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Gjyqtarët informohen në fillim të çdo shorti për:

- a) ngarkesën e çështjeve në shqyrtim, nga ku rezulton roli i secilit gjyqtar (si anëtar i trupit gjykues, si kryesues ose si relator);
- b) numrin e çështjeve që i janë caktuar me short secilit gjyqtar në rolin e relatorit, nga fillimi i procesit të rivlerësimit në Kolegj”.

Neni 2

Në nenin 6, pas pikës 4, shtohet pika 4/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Në hedhjen e shortit për caktimin e gjyqtarit relator, përjashtohen nga shorti ata gjyqtarë të cilët, në raport me gjyqtarët e tjerë të Kolegjit, kanë më shumë se tri (3) çështje të caktuara me short në rolin e relatorit, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit në Kolegj. Në rastet kur gjyqtarët të cilët do të shortohen për t’u përzgjedhur në rolin e relatorit, kanë, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit, më shumë se tri (3) çështje ngarkesë nga gjyqtarët e tjerë, shorti për përzgjedhjen e relatorit do të hidhet mes gjyqtarëve që kanë ngarkesë numër më të vogël ose të barabartë çështjesh”.

Neni 3

Ndryshimet në këtë rregullore hyjnë në fuqi në datën e miratimit të Vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe efektet e tij fillojnë nga data 08.01.2020.